



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 58, datë 26.05.2017

PËR

**DISA SHTESA NË RREGULLOREN NR. 2, DATË 25.01.2016 “PËR FORMËN,
AFATET DHE MBAJTJEN E PASQYRAVE FINANCIARE, RAPORTEVE
STATISTIKORE DHE RAPORTIMEVE TË TJERA TË NDËRMJETËSVE NË
SIGURIME DHE RISIGURIME”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 204, pika 6, 217, pika 5, 218 pika 2 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave në Rregulloren nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”, kryhen shtesat si më poshtë:

Pas nenit 7, të shtohet neni 7/1 “Raportimi i bankës dhe/ose degës së bankës së huaj për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime”, me përmbajtje si më poshtë:

Neni 7/1

Raportimi i bankave dhe/ose degët e bankave të huaja për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime

1. Përveç sa parashikuar më sipër, objekt i kësaj rregulloreje janë dhe bankat dhe/ose degët e bankës së huaj që ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime.
2. Bankat dhe/ose degët e bankës së huaj që ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime janë të detyruara të zbatojnë nenet 4,5,6 dhe 7 të kësaj rregulloreje.

Pas nenit 7/1, të shtohet neni 7/2 “Raportimi i brokerit fizik si person i regjistruar”, me përmbajtje si më poshtë:

Neni 7/2

Raportimi i brokerit fizik si person i regjistruar

1. Përveç sa parashikuar më sipër, objekt i kësaj rregulloreje është edhe brokeri fizik si person i regjistruar.
2. Brokeri fizik si person i regjistruar është i detyruar të zbatojnë nenet 4,5,6 dhe 7 të kësaj rregulloreje.